



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:075058

Datë: 25.07.2022

Numri i dokumentit: 03264940

PKR. nr. 100/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetarin e trupit gjykues Kadrije Goga Lubishtani dhe anëtarët e trupit gjykues gjyqtarët Ibrahim Idrizi dhe Hakile Ilazi, dhe zyrtaren ligjore Teuta Bega, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.D, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.94/20 të dt.03.07.2020, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 lidhur me par.3 nënpar 3.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në prani të akuzuarit, me datë 24.06.2022 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.D, nga i ati I.dhe nëna Q., e gjinisë B, i lindur më, në fshatin ..., Republika e Maqedonisë Veriore, me vendbanim ne fshatin ..., komuna Kaçanik, si dhe me vendbanim te përkohshëm ne rrugën "...", Ferizaj, ka te kryer fakultetin, Dega kriminalistikes, i punësuar si Inspektor i Pylltarisë, në komunën e Kaçanikut, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, prind i katër fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

Në kuptim të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së,

L I R O H E T N G A A K U Z A

Se me date 23.04.2020, rreth orës 10:45, ne Kaçanik, përkatësisht ne ..., i akuzuari ne cilësinë e personit zyrtar, si Inspektor i Pylltarisë ne komunën e Kaçanikut,

me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për vete apo për personin tjetër duke shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, ka tejkaluar kompetencat dhe me dashje ka shkelur ligjin lidhur me detyrat apo punësimin e tij, në atë mënyrë që ditën kritike, i mundëson personit J.B që të tërheq kamionin dhe drunjtë e ngarkuar në të, të cilat iu kishin sekuestruar paraprakisht nga policia, duke urdhëruar rojën e ..., R.D, që të njëjtë t'i liroj automjetin-kamionin së bashku me drutë, pa i ofruar kurrfarë dokumentacioni dhe pa kurrfarë baze ligjore për lirimin e të njëjtave,

Meqë nuk është provuar se i akuzuari F.D ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

Konform nenit 454 par.1 të KPP-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

1.Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën e evidentuar PP/I. nr. 94/20 të dt. 03.07.2020, ka akuzuar F.D, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 lidhur me par.3 nënpar 3.1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, duke vepruar sipas kësaj aktakuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me dt. 20.04.2021, në të cilin i akuzuari është deklaruar i pafajshëm për aktakuzën.

Gjatë zhvillimit të procedurës, i akuzuari ka paraqitur kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave andaj, gjykata me aktvendim të dt. 25.05.2021, refuzoi kërkesën e të akuzuarit dhe procedura ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale.

Në shqyrtimet gjyqësorë të mbajtura me dt.18.02.2022, 07.04.2022, 23.05.2022, si dhe me datën 22.06.2022 gjykata ka ushtruar provat duke dëgjuar dëshmitaret si dhe mbrojtjen e të akuzuarit.

Prokurori i Shtetit Sebahate Sinani në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin F.D ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim sipas ligjit.

I akuzuari ne fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata qe ndaj tij te shpall aktgjykim lirues per faktin se me provat e paraqitura gjate shqyrtimeve gjyqësore nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale.

2. Mbrojtja e të akuzuarit F.D

I akuzuari në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se i kujtohet se i mbështet deklaratimet e tij ne stacionin Policor dhe ne Prokurori dhe se me datën 23.04.2020, e ka telefonuar drejtori-F.L dhe e ka njoftuar se një kamion me dru ndodhet ne auto-park, ku pastaj i njëjti ka shkuar dhe është takuar me drejtorin dhe e ka pyetur nëse kamioni ka qene nen përcjelljen e rojeve te pyllit, e qe sipas njoftimit nga ana e drejtori kamioni nuk ka qene nen përcjellje te rojeve te pyllit. Pas kësaj i akuzuari ka deklarua se ka shkuar ne Stacionin Policor ne Kaçanik, ku ne objektin e Stacionit Policor gjegjësisht ne korridor te Stacionit e ka takuar J.B, i cili e kishte njoftuar si kishte dhënë deklarate ne Stacion Policor dhe se kamioni me dru gjendet ne auto-park.

Tutje ne mbrojtjen e tij i akuzuari ka deklaruar se bashku me J.B kane shkuar ne Auto-Park, kane shikuar kamionin, ku fillimisht J. e ka larguar ceradën-mbulesën me te cilën ishin mbuluar drunjte, e pastaj ai i ka fotografuar drunjte, ka konstatuar llojin e drunjteve dhe sasinë e tyre, ku ne ato momente kishte ardhur roja i auto-parkut R.D i cili e kishte pyetur se “çka bohet me këtë kamion”, pasi i ka kryer këto pune i ka thënë rojës R.D qe kamioni lëshohet, ndërsa J. i ka thënë drutë të i shkarkoj aty dhe menjëherë janë larguar nga auto-parku se bashku me J., ngase është përgjegjësi e rojës se auto-parkut te qëndron prezent deri sa drutë te shkarkohen, andaj ka vazhduar me J. ne komune dhe se nuk është detyre e inspektorit qe te qëndron aty deri sa te shkarkohen drunjet.

I akuzuari ka deklaruar se te njëjtën dite, ne orët e pas ditës, përmes telefonit e kishte njoftuar roja i auto-parkut R.D se J. e kishte marr kamionin nga auto-parku dhe kishte ikur.

Tutje në mbrojtjen e tij i akuzuari ka deklaruar se dita kur ka ndodhur rasti ka qene dite e premtë, dhe po sa është paraqitur te hënën ne pune, ka shkuar ne Stacionin Policor ne Kaçanik dhe ka kërkuar pro formën, ku ne baze te saj ka paraqitur fletëparaqitje kundërvajtëse për shkak te transportit ilegal te drunjtëve kundër J.B. Po ashtu te njëjtën dite ka lëshuar urdhëresë për auto-parkun dhe sektorin e pylltarisë, lidhur me automjete te cila hasen duke transportuar drunjtë ilegal dhe deri sa te kryhet konfiskimi i përkohshëm te mos lirohen pa shqimin nga inspektori.

Gjate mbrojtjes së tij është deklaruar edhe lidhur me kompetencat si inspektor i Pylltarisë e te cila burojnë nga Ligji për Inspeksionin Bujqësor kurse detyre e inspektorit te pylltarisë është verifikimi i zbatimit te Ligjit te Pyllit, dalja ne vendin e ngjarjes, matja e sasive drunore, shqiptimi i fletëparaqitjes dëmtuesve te pyjeve, lëshimi i dëshmimeve për konfiskimin e drunjtëve, ne rastet e caktuar kur kem te bëjmë me vepër penale te kryer nga dëmtuesit e pyjeve e lëshojmë edhe flet konfiskim për automjet, verifikimin e dokumentacionit zyrtar etj.

3. Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk kanë pranuar fajësinë sipas pretendimeve të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëren me tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitët e këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit F.D dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- nga dëgjimi i dëshmitarëve R.D, F.L, N.M dhe J.B gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- nga deklarata dhe raporti ditor i përpiluar nga roja e ...t me datën 23.04.2020
- nga proforma mbi transportin ilegal te drunjtëve e datës 24.04.2020,
- Paralajmërimi verbal i shqiptuar ndaj te pandehurit F.D nga ana e drejtorit te DBZHRP ne Kaçanik me numër ... e datës 06.05.2020
- Kërkesa për fillimin e procedurës kundervajtëse kundër J.B, e lëshuar me datën 30.04.2020, nga inspektori komunal per pylltari ne komunën e Kaçanikut,

- Lista e distribuimit e lëshuar ne forme te njoftimit me datën 12.05.2020 nga inspektori i pylltarisë nga komuna e Kaçanikut,
- Paralajmërimi verbal i datës 06.05.2020, e lëshuar nga drejtori i DBZHRP- F.L,
- Kërkesa per fillimin e procedurës penale nga DBZHRP ne Kaçanik, e datës 20.06.2020,
- urdhëresë e Sektorit te Pylltarisë dhe Autoparkut, e lëshuar nga DBZHRP ne Kaçanik, e datës 12.05.2020,
- Ankesa per paralajmërimin verbal te datës 06.05.2020, e lëshuar nga inspektori i pylltarisë F.D, e datës 08.05.2020,
- Urdhëresa e lëshuar nga inspektori i pylltarisë F.D, e datës 24.04.2020,
- Kontrata e lidhur ne mes kryetarit te komunës dhe kryetarit te SHIL-UÇK per shfrytëzimin e Autoparkut, e datës 31.07.2019

4. Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuar dhe të pakontestueshme në aspektin objektiv përkatësisht faktet si në vijim:

- se i pandehuri F.D, punon si Inspektor i Pylltarisë ne Komunën e Kaçanikut
- se i akuzuari F.D ka ndalur ne autoparkun dhe ka shiquar kamionin me drunje,
- se rojës se autoparkut dëshmitarit R.D, i ka thënë se automjeti duhet te lirohet.
- se dëshmitari J.B ka tërhequr kamionin e tij se bashku me drunjet e ngarkuar nga autoparku pa u dorëzuar proforma.
- se i akuzuari ka pranuar një paralajmërim verbal për shqiptimin e masës disiplinore nga drejtori i DBZHRP F.L për urdhëresën e lëshuar autoparkut
- se ndaj dëshmitarit J.B, është filluar procedure kundervajtese.
- se ka qene praktike e autoparkut zakonisht masa drunore është shkarkuar ne autopark, kurse automjetet kur i kane plotësuar kushtet janë liruar.

Andaj në këtë çështje penale ka qenë kontestuese vërtetimi i fakteve për implikimin e të akuzuarit F.D, përkatësisht vërtetimi i fakteve të përshkruara si në dispozitiv e këtij aktgjykimi, se a e ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare me qëllim të përfitimit pasuror a ka

tejkualuar kompetencat me dashje dhe a ka shkelur ligjin lidhur me detyrat apo punësimin e tij dhe se a i ka mundësuar personit J.B qe te tërheq kamionin dhe drunjet e ngarkuar.

Lidhur me këtë dëshmitari R.D ne dëshminë e tij te dhënë ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se zakonisht fillon punën çdo dite si roje e Autoparkut ne orën 08:00, kurse me datën 23.04.2020 për afërsisht rreth orës 10:00 policia dhe rojet e pyllit e kishin sjell një kamion me dru, vozitës i atij kamioni ishte J.B, te cilin policia e kanë shoqëruan për në Stacionin Policor, i kujtohet se atë dite ishte duke u përgatitur qe me kamionin te cilin e disponon Autoparku te shkoj për te iu ndihmuar kompanisë se ujësjellësit ne fshatin ... pasi qe kishin nevojë për një kamion me vinç, ne ato momente kishte ardhur policia dhe i kishin thënë se ti nuk guxon ta lirosh vendin e punës por duhet te qëndrosh këtu për te ruajtur parkingun dhe kamionin me dru te cilin e kishin sjelle.

Dëshmitari ka deklaruar se rreth gjysme ore me vone ne .. kanë ardhur F.D, J.B dhe një person tjetër i cili e voziste veturën .. dhe kane bere shikimin e kamionit, ku J.i e kishte hequr ceradën-mbulesën me te cilën ishin mbuluar drunjet, ndërsa F.D kishte bere fotografimin e drunjeve, e pastaj i kishte thënë “kamionin me gjithë dru lirohet”, dokumentacionin lidhur me lirimimin e kamionin ta sjell me vone dhe ishte larguar.

Tutje dëshmitari ka deklaruar se atë dite rreth orës 15:00 ose 16:00, kishte ardhur kryetari i Shoqatës se Invalidëve te Luftës R.D dhe e kishte pyetur se pse i kishte liruar drunjet dhe dëshmitari i ishte përgjigjur se drunjet i ka liruar F., e pastaj e kishte telefonuar F., për ta pyetur për dokumentacionin lidhur me lirimimin e drunjeve, ku gjate bisedës F. i kishte thënë se “*une te kam thënë lëshojë kamionin por jo edhe drutë*”.

Dëshmitari ka deklaruar se ne Autopark punon qe 15 vite, dhe për te gjitha hyrje-daljen ne ..., roja e ka obligim qe ti evidenton ne librin e evidencave (libri i rojës), dhe edhe atë dite të gjitha i ka shënuar ne librin e evidencave.

Gjate deklarimit te tij dëshmitari përmend edhe faktin se është rregull ne ... qe kur hynë automjeti nga pylltari apo policia i merret çelësi i automjetit i cili dorëzohet tek roja e .., e qe ne rastin konkret për atë kamion nuk i është dorëzuar çelësi. Po ashtu gjate deklarimit te tij përmend edhe faktin se rojet e pyllit kur e sjellin automjetin me dru, pa ardhur inspektori apo dikush nga komuna ata nuk mund te vlerësojnë asgjë, pasi qe ata marrin një dokument qe i thonë ‘*proforma*’ prej policisë e pastaj ia japin inspektorit, inspektori vlerëson dhe neve ne .. na ngarkojnë me atë sasi drunore, e qe inspektori është i obliguar qe deri sa te shkarkohet masa drunore te qëndroj aty.

Dëshmitari gjate deklarimit te tij tregon edhe për një kamion tjetër i ardhur nediku rreth orës 13:00, mire po atë kamion e kishin shkarkuar pylltarët e pastaj kane ardhur inspektoret dhe e kane bere vlerësimin e drunjeve.

Gjykata me kujdes e ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit R.D, mirëpo nga kjo dëshmi e tij e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata nuk ka mundur ti vërtetoj pretendimet faktike të paraqitura në dispozitivin e aktgjykimit, sepse i njëjti deklarimet e tija fillimisht ka treguar se ka qene për nguti për te ju ndihmuar kompanisë se ujësjellësit për një defekt ne fshatin ..., dëshmitari gjate dëshmisë se tij vërteton faktin se F.D, ka ardhur ne autoparkun per te bere shikimin dhe matjen e sasive drunore, mire po kur i është thënë se duhet te lirohet kamioni ne këtë kontekst dëshmitari e kishte kuptuar te lirohet kamioni me gjithë dru, për këtë dëshmitari ne dëshminë e tij ka sqaruar edhe faktin se zakonisht çelësi i automjetit i cili parkohet ne autopark i dorëzohet rojës, e te cilën gjë ne rastin konkret nuk e kishte pranuar. Dëshmitari me korrektësi deklaroi se J.B e kishte marr kamionin me drunjet e ngarkuar ne te, por dëshmitari nuk ka mundur ta vërteton se i akuzuari a ka përfituar ndonjë dobi pasurore nga personat te tjerë apo për personat te tjerë nuk ka mundur te vërteton as faktin se i akuzuari a ka kaluar kompetencat dhe detyrat e tij te punësimit, përveç se dëshmitari ne mënyrë kronologjike ka vërtetuar rrjedhën e tere ngjarjes ditën kritike, si dëshmitar ne mënyrë te drejtpërdrejt nuk ka mundur te bene sqarimin e fakteve vendimtare mbi të cilat edhe është ndërtuar dispozitivi i aktakuzës, për me tepër ky dëshmitar e zbeh dëshminë e tij kur përmend se çelësi mbetet te roja e qe ne rastin konkret, çelësi nuk ka mbetur te roja po kamioni është ndezur me tastierë, kurse çelësi i derës ka qene jashtë funksionit, luhatje gjate dëshmisë se tij pat edhe ne rastin kur përshkruan veprimin e shkarkimit te drunjeve nga kamionët, e cila ndodh sipas praktikave ne Autopark e qe ne rastin konkret ka deklaruar se duhet te qëndron Inspektori, kurse per rastin tjetër tregon se roja e pyllit ka qene prezent gjate shkarkimit te masës drunore.

Deklarimi i këtij dëshmitari i cili gjate procedurës paraprake ishte “bindës” dhe mbi dëshminë e te njëjtit ishte ndërtuar edhe dispozitivi i akuzës, deklarimi i tij ne shqyrtimin gjyqësor dëshmitari i zbeh dëshminë e tij duke deklaruar se tani i akuzuari-Inspektori sipas

praktikave te Autoparkut duhet te qëndron deri sa te zbrazet masa drunore dhe ne anën tjetër përmend faktin se roja e pyllit duhet me qene prezent gjate shkarkimit te masës drunore. Andaj për gjykatën mbetet kontestuese se kush duhet te jetë prezent gjate shkarkimit te masës drunore, a duhet te dorëzohet çelësi i automjetit te sekuestruar te roja e Autoparkut dhe se roja i

Autoparkut a duhet te lejon qe automjeti te dale jashtë Autoparkut pa ndonjë dokumentacion konkret e qe kjo me se miri vërtetohet edhe nga raporti i punës se rojës ku per orën 10:45 lejohet te dal kamioni ne rastin konkret pa shënuar se a është pajisur me ndonjë dokumentacion konkret dhe ne po te njëjtit raport dhe te njëjtën date shënimet e orës 13:00 lejohet te dal automjeti nga Autoparku, mire po duke mos dorëzuar ndonjë dokument përcjellës-flet konfiskimin pasi qe sipas këtij raporti shkruan se “thane se nesër ia sjellim”

Dëshmitari F.L, ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se qëndron pranë deklarami të tij të dhënë në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe ka sqaruar se në rastin kur policia konfiskon mase drunore, e thërret rojën e pyllit dhe nën përcjellje të tyre masën drunore se bashku me automjetin e dërgojnë ne autopark, ku aty roja e pyllit ne ditarin e tij duhet te evidentoj saktësisht gjendjen e automjetit dhe te drunjeve, e pastaj policia harton një raport-proforme, njoftohet drejtoria e pyjeve, ku drejtori e njofton inspektorin apo zyrtarin qe te shkon ne polici ta merr proformen e pastaj shkon ne autopark te shikoj gjendjen faktike, e pastaj te paraqes fletëparaqitje. Inspektori me urdhër te drejtorin merr detyrën për të shkuar në autopark.

Dëshmitari ka deklaruar se me F.D është takuar ne zyrën e tij, ku i njëjti i ka treguar se e kishte liruar kamionin e J.B, e që dëshmitari i kishte thënë se ju nuk keni të drejte të veproni në atë mënyrë.

Tutje dëshmitari deklaroi se nuk e din qe ka ndonjë rregullore apo udhëzim administrativ ku thuhet se inspektori duhet te qëndron aty deri sa te zbrazen drunjet, mire po sipas praktikës se tyre inspektori gjithmonë ka qëndruar aty apo ndonjë zyrtar tjetër dhe pasi është zbrazur kamioni atij i është lejuar qe te shkon.

Komuna se bashku me autoparkun kane një marrëveshje ku autoparku përmes rojeve-stafit te vet kujdeset për automjetet te cilat vendosen aty, masën drunore dhe gjithçka qe hynë brenda autoparkut dhe ne momentin kur largohet inspektori nga autoparku përgjegjësitë për drunjet te cilat ndodhen ne autopark i bart stafi i autoparkut, inspektori i pylltarisë merret vetëm me konfiskimin-sekuestrimin e masës drunore dhe mjeteve me te cilat barten. Inspektori i pylltarisë detyrat e punës i ka te rregulluara me Ligjin për Inspeksionin Bujqësor, mire po inspektori i pylltarisë mund te i ndihmon edhe për çdo problem ku haset Drejtoria e Pylltarisë ne atë rajone.

Lidhur me këtë rast, inspektorit F.D ne i kemi shqiptuar një vërejtje me goje, brenda kompetencave tona se i njëjti nuk ka pasur te drejte te veproje ne atë mënyrë, dhe ndaj tij nuk është udhëhequr ndonjë procedure tjetër disiplinore ngase për këtë rast është marr hetuesia.

Nga vlerësimi i dëshmisë se dëshmitarit F.L, është vërtetuar fakti se ne cilësinë e drejtorit DBZHRP-se i ka sqaruar gjykatës obligimin e inspektoreve te pylltarisë, po ashtu edhe obligimet e rojës se pyllit, procedurat se kur ndalohet masa drunore nga roja e pyllit, se si vlerësohet nga inspektori dhe si mund edhe te konfiskohet nga ana e policisë si dhe ka sqaruar fakti se me urdhër te drejtorit inspektori e merr detyrën për te shkuar ne autopark, e qe ne rastin konkret nuk ka sqaruar se te akuzuarit F.D ne cilësinë e inspektorit a i ka dhënë urdhër per te shkuar ne autopark, por se dëshmitari ka sqaruar rrethanën tjetër duke përmendur se gojarisht i ka thënë i akuzuari se..... *“J.B ia ka mundësuar lirim e kamionit për faktin se i njëjti ka qene ne procedure te një vize amerikane,..... dhe ka kërkuar qe te njëjtit mos te i behet fletparaqitje fare qe te mos te i shkaktoj ndonjë pengese lidhur me udhëtimin....”* gjykata gjate vlerësimit te këtij fakti ka vlerësuar se kjo ka qene sipas dëshmitarit vetëm nje komunikim, por ne suaza te ndonjë dokumentacioni zyrtar dëshmitari nuk ka ofruar per te forcuar deklarimin e tij dhe vlerësimin sa me te besueshëm, por ne një fragment te dëshmisë se tij vërteton faktin se ne momentin kur largohet inspektori nga Autoparku, përgjegjësitë për drunjet te cilat ndodhen ne Autopark i bartte stafi i Autoparkut, e qe ne rastin konkret Inspektori i Pylltarisë nuk është i thirrur qe te barte përgjegjësitë për drunjet ne Autopark por i njëjti merret vetëm me konfiskimin-sekuestrimin e masës drunore dhe mjeteve me te cilat bartet.

Edhe nga ky dëshmitar gjykata nuk ka mundur te vërteton qëllimin e përfitimit te dobisë se kundërligjshme pasurore apo nuk ka mundur te vërteton as shfrytëzimin e detyrës zyrtare apo tejkalimin e kompetencave ne lidhje me detyrat dhe punësimin e te akuzuarit F.D.

Dëshmitari N.M, ne shqyrtimi gjyqësor ka deklaruar gjate vitit 2020 ka punuar si roje pylli ne kuadër te drejtorisë se Pylltarisë ne komunën e Kaçanikut dhe se i kujtohet se ka dhënë një deklaratë ne Stacionin Policor ne Kaçanik lidhur me rastin e J.B dhe F.D. I kujtohet se ditën kritike kishte punuar ne ndërrimin e natës-kujdestari, dhe diku ne orën 08:00 te mëngjesit ishte njoftuar nga drejtori F.L qe policia kufitare kishte ndaluar nje kamion me dru dhe duhet te shkonte te shikonte gjendjen. I njëjti deklaroi se kur kishte arritur ne vendin e caktuar , kishte kontaktuar me policin dhe kishte marr shënimet e personit-J.B, ku te njëjtit e kishte urdhëruar qe ta hiqte ceradën e kamionit dhe aty kishte pare drunjet te cilat kishin qene te pa damkosura

dhe pa fletpercjellje, te llojit qarr e bung dhe kishte bere marrjen e tyre, ku aty ishin rreth 8 metra dru, e pastaj kishte udhëzuar policinë se ato drunje duhet te shkonin ne autopark për procedura te mëtutjeshme. Tutje dëshmitari ka deklaruar se kishte shkuar ne zyrën e drejtorit F. dhe e kishte njoftuar se kamioni dhe drunjet gjenden ne autopark dhe kishte kërkuar nga ai qe ta lironte pasi qe kishte punuar ne ndërrimin e natës, po ashtu deklaroi se aty kishte ardhur F.D te cilin drejtori e kishte ngarkuar me detyrën- qe te merret me policinë dhe kamionin (rastin e J.B).

Nga vlerësimi i dëshmisë se dëshmitarit N.M gjykata ka vërtetuar se i njëjti ne cilësinë e rojës se pyllit është njoftuar nga drejtori F.L dhe A.L te cilët e kane njoftuar se policia kufitare e kishte ndaluar një kamion me dru, ku se bashku me kolegun e tij A.Rr kishte shkuar ne vendin e ngjarjes, dëshmitari vërteton se kontaktin e pare e kishte pasur me policinë aty kishte takuar J.B i kishin marr shënimet, e kishin zbuluar rimorkion e kamionit ku kishin pare drutë dhe e kishin shoqëruar kamionin gjer ne Autopark. Dëshmitari ka sqaruar se menjëherë ka njoftuar drejtorin qe drutë duhet te zbrazen mire po për shkak se policia e kishin marr J.B për te dhënë një deklaratë, ai e kishte njoftuar rojën e Autoparkun R. qe këto dru nuk guxojnë te dalin nga autoparku pa një vendim te drejtorisë.

Te deklarimi i këtij dëshmitari gjykata ka vlerësuar edhe faktin se ne Autopark edhe një here është çelur cerada për te shkarkuar drutë, mire po J. nuk i ka shkarkuar. Pas kësaj dëshmitari ka shkuar ne drejtori dhe kishte kërkuar qe te lirohet te shkon ne shtëpi për shkak se kishte punuar ne ndërrimin e natës. Nga deklarimi i dëshmitarit vërtetohet e tere rrjedha prej momentit kur është ndaluar kamioni me dru dhe deri te momenti kur J.B nuk i ka shkarkuar drutë ne autopark ka qëndruar pranë dhe i njëjti ne mënyrë kronologjike ka përshkruar tere ngjarjen, ky dëshmitar ka deklaruar se ne zyrën e drejtorit kishte ardhur edhe F.D te cilin drejtori e kishte ngarkuar me detyrën qe te merret me policinë dhe kamionin por nga vlerësimi i dëshmisë se këtij dëshmitari, gjykata nuk ka mundur qe te vërteton përshkrimin e dispozitivit te akuzës përveç se ka vërtetuar rrjedhën kronologjike te rastit te ndodhur.

Dëshmitari J.B ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me datën 23.04.2020, është hasur nga policia duke transportuar drunjte, për te cilat nuk kishte asnjë dokumentacion për transportin apo prerjen e tyre, e pastaj ne percjellje te policisë dhe rojeve te pyllit është shoqëruar për ne autopark, aty ku e kishte lënë kamionin e tij se bashku me drunjte, për te vazhduar për ne Stacionin Policor ne Kaçanik për te dhënë deklaratën e tij lidhur me transportin ilegal te drunjeve, ndërsa deklaroi se lidhur me rastin (zyrtarin-F.D) asnjëherë nuk ka dhënë ndonjë deklaratë as ne polici, as ne prokurori e as ne gjykatë.

Tutje dëshmitari deklaroi se kishte shkuar në kuvendin komunal në Kaçanik, në zyrën e F.D, ku e kishte informuar rreth kamionit të tij dhe e kishte pyetur për procedurën se si ta tërhiqet kamionin e tij, i cili e kishte njoftuar se fillimisht duhet të zhvillohet procedura rreth drunjeve e pastaj të merret vendim për lirimin e kamionit.

Gjithashtu dëshmitari ka deklaruar se bashku me F.D kishin shkuar në autopark, ku F. i kishte fotografuar drunjët, kishte konstatuar llojin dhe sasinë e tyre dhe se bashku me ta ishte edhe roja e autoparkut, i cili sipas dëshmitarit kishte qëndruar tërë kohën aty dhe e kishte pyetur F. se a do të lirohet kamionin apo do të mbetet në parking pasi që i njëjti kishte për të përfunduar një punë në terren, për të dërguar një luge të bagerit në fshatin për kompaninë B..., e që pastaj F. i ishte përgjigjur se “kamioni do të lirohet” ndërsa sa i përket drunjeve nuk kishte thënë asgjë, e pastaj ishte larguar nga autoparku.

Se bashku me F.D kishin shkuar në autopark ku kishte çelur ceradën-mbulesën e rimorkios, F. i ka matur drunjete ka konstatuar llojin e drunjeve, mirë po nuk i kishte dhënë asnjë dëshmi për matjen dhe llojin e drunjeve, përveç se të njëjtat i kishte fotografuar, pastaj e ka mbuluar rimorkionin, me automjetin e tij e kishte dërguar F. deri në komunë dhe pastaj ishte kthyer në autopark dhe e kishte shfrytëzuar momentin, pasi që kishte kuptuar që nuk kishte pasur një komunikim të rrjedhshëm në mes F.D dhe rojtari të autoparkut dhe e kishte marrë kamionin e tij së bashku me drunje, pa asnjë dokumentacion lidhur me lirimin e tij.

Tutje dëshmitari shton se pasi e kanë ndaluar policia deri të autoparku kamionin e ka vozitur vet, e ka parkuar në autopark, prezent ka qene roja i autoparkut-R., por se kamioni nuk ka pasur çelës ngase i njëjti është ndezur me tastierë, çelësi i derës së kamionit nuk ka funksionuar, nga autoparku është shoqëruar për në stacionin policor nga policet për të dhënë deklaratë, njëren tabelë të regjistrimit të kamionit ia kanë marrë policia, kurse tabelën tjetër nuk e ka poseduar pasi që e njëjta i kishte humbur kohë më parë.

Policia dhe pylltarët në momentin kur ishte ndaluar e kishin pyetur se a ka dokumentacion për prejardhjen e drunjeve dhe transportin e tyre, po ashtu edhe leje për prerjen e drunjeve, damkosjen e tyre dhe për këtë shkak pasi që nuk i posedonte të njëjtat e kanë shoqëruar deri në autopark, po ashtu të njëjtat pyetje i kishte shtruar edhe F. se a ka ndonjë fletpercejelës apo dokumentacion tjetër.

Gjithashtu dëshmitari ka deklaruar se asnjëherë nuk i kishte kërkuar F.D që të mos i shkruajë paraqes fletparaqitje për transport ilegal të drunjeve, dhe që nga momenti kur e kishte marrë kamionin së bashku me drunje nga autoparku, asnjëherë me nuk është ftuar nga organet

kompetente lidhur me kamionin, edhe pse te njëjtin kamion e kishte vozitur edhe nje vit pas ndodhjes se rastit.

Lidhur me këtë rast është dënuar nga gjykata ne Kaçanik-Divizioni Kundërvajtës per transport ilegal te drunjeve.

Nga vlerësimi i dëshmisë se dëshmitarit J.B gjykata ka vërtetuar faktin se është hera e pare qe i njëjti deklarohet pasi qe asnjëherë nuk është ftuar nga institucionet per te dëshmuar ne lidhje me rastin F.D, i kujtohet se ka qëndruar ne zyrët e kuvendit komunal, ju ka treguar se është takuar nga policia ku janë takuar ne Kaçanik tek Autoparku i Veteraneve, dëshmia e tij përputhet edhe me dëshminë e dëshmitarit rojës se Autoparku R., po ashtu edhe me te pylltarit N.M, dëshmitari ka vërtetuar edhe faktin se nuk ka kërkuar nga F. qe te mos i shkruaj fletparaqitje, ky dëshmitar ka vërtetuar edhe faktin se komunikimi ne mes te F.D dhe rojës se autoparkut R.D , nuk ka qene komunikim i rrjedhshëm, andaj ne saje te këtij komunikimi ka shfrytëzuar rastin dhe ka marr kamionin ngase kamioni i tij është ndezur vetëm me tastierë pa çelës, po ashtu dera e kamionit nuk ka funksionuar me çelës, andaj ka shfrytëzuar rastin per te tërhequr kamionin.

Dëshmitari ne dëshminë tij ishte mjaft korrekt dhe objektiv, dëshmia e tij përputhet edhe me veprimet te cilat i kane deklaruar dëshmitaret tjerë por edhe me mbrojtjen e te akuzuarit, duke përshkruar tere kronologjinë e rastit dhe e njëjta duke u ndërlidhur edhe me dëshmitë e tjera.

Dëshminë e këtij dëshmitari gjykata e vlerësoi si nje dëshmi kyqe ngase është dëshmitari i cili drejtpërdrejt eshte ballafaquar me rastin, andaj i njëjti ne mënyrë kronologjike dhe te thjeshte ka përshkruar tere rrjedhën e ngjarjes, si një dëshmitar i cili ka mundur te shfrytëzon rastin qe nga autoparku te tërheq kamionin me masën drunore mire po ky dëshmitar ne asnjë

pjesë te deklarimit te tij nuk ka mundur te vërteton faktin e ndonjë përfitimi te kundërligjshëm nga ana e inspektorit F.D, përveç se ky dëshmitar vërteton faktin se ne mënyrën e tij ka mundur te tërheq kamionin dhe drute e ngarkuara ne te dhe te arrin qëllimin e përfitimit vetëm për vete, mire po për këtë përfitim i njëjti është dënuar nga gjykata ne Kaçanik –Divizioni Kundërvajtës për transport ilegal te drunjeve.

Nga vlerësimi i raporti ditor i përpiluar nga roja e Autoparkut me datën 23.04.2020, me te cilën është konstatuar se roja e parkut ka konstatuar se policia dhe pylltarët kane sjellë J.B ne

parking me kamionin me dru, mire po pas gjysme ore ka ardhur F.D ne ora 10:45, e ka liruar me dal nga Autoparkingu. Po ashtu ne kete pjese te raportit te punës se rojës eshte shkruar se po te njëjtën dite se ne orën 13:00 policia se bashku me rojet e pyllit prap e kan sjellur nje kamion tjetër te ngarkuar me dru, mire po i shkarkuan drutë dhe pylltarët e liruan dhe thane se nesër ja nsjellim fletkonfirmimin, nga kjo prove gjykata ka vërtetuar se po te krahasohet ky raport se si ne ora 13:00 roja e pyllit ka liruar nje kamion tjetër dhe fletkonfirmimin e sjellin te nesërmen, kurse e njëjta gje kur F.D ka liruar kamionin sipas këtij raporti ne kete raport nuk eshte shënuar se kur do te silllet fletkonfirmimi, andaj gjykata kete raport e vlerëson si raport jo te plote, ne raport me te akuzuarin F.D.

Nga vlerësimi i proformes mbi transportin ilegal te drunjtëve e datës 24.04.2020, vërtetohet se eshte lëshuar nje dite me vone se ditën kur ka ndodhur ngjarja, ne kete proforme përcaktohet sakte kush eshte ndalur, ne cilin vend, çfarë kamioni dhe transportin e drunjeve po ashtu eshte përcaktuar se kamioni dhe drunjet janë dërguar ne autoparking, drunjet janë konfiskuar ndërsa J.B i eshte shqiptuar nje tikete kundervajtese.

Nga vlerësimi i paralajmërimi verbal i shqiptuar ndaj te pandehurit F.D nga ana e drejtorit te DBZHRP ne Kaçanik me numër 322/01-9482 e datës 06.05.2020, eshte vërtetuar se inspektorit te pylltarisë F.D i shqiptuar masa disiplinore-Paralajmerim Verbal dhe ne piken 2 keshillohet s ene rast te përsëritjes se veprës se njëjtë do te i shqiptohet masa tjera te parapara me ligj dhe rregulloret ne fuqi, ne baze te kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se ne rast te ketë ndodhur ndonjë lëshim gjat detyrave te punësimit nga ana e inspektorit F.D te njëjtiti i është shqiptuar nje mase nga institucioni ku ai punon konkretisht drejtori, andaj sikurse te kish pasur ndonjë lëshim tjetër me te rende atëherë drejtori nuk do te i shqiptonte mase disiplinore përveç se i njëjti do te hetohej per vepre penale, e qe kjo është bere pas shqiptimit dhe vlerësimit nga ana e drejtorit te kësaj mase e qe aktvendimi per fillimin e hetimeve eshte marr me datën 24.06.2020 si rezultat i asaj se prokuroria Themelore ne Ferizaj ka pranuar kallëzim penal per te pandehurin F.D me datën 16.06.2020.

Nga vlerësimi i kërkesës per fillimin e procedurës kundervajtëse kundër J.B, e lëshuar me datën 30.04.2020, nga inspektori komunal per pylltari ne komunën e Kaçanikut, është vërtetuar se ndaj J.B eshte iniciuar procedure kundervajtëse pasi qe me kamionin e tij ka ngarkuar drunje te pa damkosura, pa vule transporti pa fletpërcjellëse për transport ne sasi prej 5.60 m3, dhe se këtë kërkesë i akuzuari e ka ushtruar para se te njëjtiti te i shqiptohet paralajmërimi verbal, me

kete vërtetohet se inspektori ka kryer detyrën e tij te punës pasi ka pranuar proformen me datën 24.04.2020, kurse kërkesën e ka ushtruar pas katër dite pune dhe ate me 30.04.2020 , andaj ka vepruar brenda suazave te përcaktuara me ligj.

Nga vlerësimi i Listës se Distribuimit e lëshuar ne forme te Urdhëresës me datën 24.04.2020 nga inspektori i pylltarisë nga komuna e Kaçanikut, është urdhëruar autoparku se çdo automjet qe hynë ne autopark me transportim ilegal te drunjeve, pa shikimin nga inspektori te mos lirohet.

Nga vlerësimi i Kërkesa për fillimin e procedurës penale nga DBZHRP ne Kaçanik, e datës 26.06.2019, me te cilën vërtetohet se inspektori i pylltarisë ka ushtruar kallëzim penal ndaj një personi, i cili nuk ka qene i pajisur me dokumentacion përkatës, me këtë prove inspektori i pylltarisë F.D ka dëshmuar se ka kryer punën e tij brenda detyrës se tij zyrtare, ku edhe ka paraqitur kërkesë per fillimin e procedurës penale.

Nga vlerësimi i Listës se Distribuimit e lëshuar ne forme te Njoftimit Sektorit te Pylltarisë dhe Autoparkut, e lëshuar nga DBZHRP ne Kaçanik, e datës 12.05.2020, me te cilën është shfuqizuar urdhëresa e datës 24.04.2020

Nga vlerësimi i Ankesës për paralajmërimin verbal te datës 06.05.2020, e lëshuar nga inspektori i pylltarisë F.D, e datës 08.05.2020, me te cilën i drejtohet kryetarit te komunës lidhur me paralajmërimin verbal qe i është bere nga ana e drejtorit rreth urdhëresës se tij te drejtuar autoparkut.

Nga vlerësimi i kontratës se lidhur ne mes kryetarit te komunës dhe kryetarit te SHIL-UÇK për shfrytëzimin e Autoparkut, e datës 31.07.2019, me te cilën vërtetohet se komuna e Kaçanikut ka lidhur kontrate me shoqatën e invalidëve te luftës (SHIL te UÇK) se mund te shfrytëzojnë autoparkun duke vendosur automjetet dhe masën drunore te konfiskuara nga organet kompetente.

Andaj pas vlerësimit të të gjitha provave materiale dhe dëgjimi i dëshmitarëve të cekur më lartë, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj se i akuzuari ka kryer veprat penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 1 lidhur me par 3 nenpar 3.1 te KPRK-së të përshkruara si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, e veçanërisht nuk është vërtetuar se i akuzuari si person zyrtar ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare si dhe nuk ka tejkaluar kompetencat lidhur me detyrat apo punësimin e tij, meqë nuk është provuar se ka kryer këtë vepër penale.

5. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Mbrojtja e të akuzuarit F.D në të gjitha fazat e procedurës është përqendruar në kundërshtimin e fakteve se i njëjti kishte kryer veprën penale të përshkruara si në aktakuzë, duke paraqitur mbrojtjen e tij në hollësi si në procedurën paraprake si në para trupit gjykues, andaj gjykata e ka vlerësuar se mbrojtja e tij për faktet vendimtare të kësaj çështje penale, përkatësisht se i njëjti ka kryer detyrën e tij brenda suazave të detyrave të punës, ku i njëjti kategorikisht mohon faktin se ka mundur të thotë rojës se autoparkut që “kamioni të lirohet me dru”, i njëjti e pohon se ka thënë “kamioni duhet të lirohet” e që e njëjta është e rregulluar brenda kompetencave të përcaktuara me ligjin për Inspeksionin e Pyjeve, një mbrojtje e tillë është besueshme meqë e njëjta mbështet në tërësi me deklarin e dëshmitarëve të cilët edhe ata për gjykatën në mënyrë të sakte bindëse dhe konkrete nuk kanë mundur të precizojnë se me të vërtetë F.D gjatë deklarinimit të tij të ketë thënë se kamioni duhet të lirohet me dru por e njëjta edhe në provat tjera materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur të vërtetohet.

6. Analiza e ligjit material dhe fjalës përfundimtare të Prokurorit të shtetit

Trupi gjykues konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 1 lidhur me par 3 nenpar. 3.1 të KPRK-se, ku sipas kësaj dispozite këtë *“vepre penale e kryen personi zyrtar i cili tejkalon kompetencat e tij dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete apo personin tjetër apo të shkaktoj dëm personit tjetër, kurse në paragrafin 3 shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë por nuk kufizohet në 3.1 në shkelje me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat ose punësimin e zyrtarit”*.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale, konsiston në përfitimin e çfarëdo dobie për vete apo personin tjetër apo që të shkaktoj dëm personit tjetër ose të shkel të drejtat e personit tjetër.

Pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetër, e në mungesë të provave në këtë çështje penale nuk janë vërtetuar elementet e figurës së veprës penale që i ngarkohet të akuzuarit, kjo për faktin se nga provat materiale të siguruar nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit të jenë manifestuar

elementet e veprës penale, se nga paralajmërimi verbal i ushtruar nga drejtori i DBZHRP me numër 322/01-9482 e datës 06.05.2020, te akuzuarit ne cilësinë e Inspektorit te Pylltarisë i është shqiptuar masa paralajmërim verbal dhe është këshilluar qe nëse ndodh ndonjë lëshim gjate detyrave te punësimit do te pasoj ndonjë mase me e rende. E sikur te kishte ndodhur ndonjë lëshim i rende nga ana e Inspektorit-te akuzuarit, atëherë do te hetohej për ndonjë vepër penale, po ashtu edhe me ankesën lidhur me paralajmërimin verbal te ushtruar nga ana e te akuzuarit me datën 06.05.2020, i njëjti paraqet kundërshtimet e tij dhe te drejtat te cilat i ka pasur brenda kompetencave te veta për lëshimin e Urdhëresës drejtuar Autoparkut, edhe nga “proforma” për transportin ilegal te drunjeve e datës 24.04.2020, përcaktohet sakte se kush është ndaluar dhe ne proforme shkruan se drunjet janë konfiskuar dhe është shqiptuar tiketa kundervajtese.

Prandaj pretendimet e Prokurorit të Shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare, i cili ka mbetur pranë aktakuzës së dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke propozuar që të akuzuarin F.D ta shpall fajtor dhe të i shqiptohet dënim sipas ligjit.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka përshkruar provat e prezantuar gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat janë elaboruar hollësisht si më lartë, e për të cilat gjykata ka dhënë vlerësime për secilën veç e veç, e nga ato shpjegime të dhëna në mënyrë të çartë për të gjitha këto prova materiale dhe për gjitha dëshmitë e dëshmitarëve, nga të gjitha këto gjykata nuk ka mundur ti vërtetoj pretendimet e prokurorit të shtetit të theksuara në fjalën përfundimtare, për faktin se këto pretendime të prokurorit të shtetit janë në kundërshtim me të gjitha ato që u theksuan më lartë pasi që nga këto prova materiale në thelb nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari është kryes i kësaj vepre penale sipas kësaj aktakuze.

Prokurori i shtetit gjate fjalës përfundimtare dhe ne pjesën me te madhe te saj ka paraqitur veprimet e palëve ne procedure te cilat nuk kane qene kontestuese ne mes tyre kurse nuk ka paraqitur asnjë te dhënë bindëse ne drejtim te kryerjes se kësaj vepre penale.

Ne kontekst te kësaj edhe vet përshkrimi i dispozitivit te akuzës është i pa qarte dhe konfuz ne pjesën ku është përshkruar *me dashje ka shkelur ligjin lidhur me detyrat apo punësimin e tij*..... duke mos paraqitur asnjë argument se si ka mundur te shkel detyrat e punës për përfitimin e dobisë pasurore te kundërligjshme, ku ne provat materiale te propozuara ne aktakuze dhe te ushtruara ne shqyrtimin gjyqësor nuk përshkruhen sakte detyrat apo punësimi i tij, prokuroria nuk ka ofruar kurrfarë prove-rregullore lidhur me punësimin e Inspektorit dhe

mbi bazën e shkeljes se detyrave te punësimit çfarë dobie pasurore te kundërligjshme përfitoji i akuzuari apo ndonjë person tjetër.

Andaj nga e gjithë kjo qe u tha e duke marr parasysh faktin se gjykata me rastin e vlerësimit dhe vendosjes ka obligim ligjor te qe provoj te gjitha faktet ne mënyrë te gjithanshme dhe te pakontestueshme, pra faktet qe shkojnë ne favor te te akuzuarit e ne veçanti lidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë *“in peius”* ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë *“in favorem”* ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për me tepër është e padiskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e te akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i gjykatës do te kuptohej si i kundërt dhe ne këtë mënyrë lëvizja e barrës se provës nga organi i akuzës ne ta akuzuarin, e cila është ne kundërshtim esencial te njërit prej parimeve fundamentale te procedure penale e përcaktuar me nenin 7 te KPPRK-se dhe e garantuar me neni 62. Te KDLNJ-se.

Prandaj sipas vlerësimit te gjykatës ne rastin konkret me provat e propozuara dhe te zbatuara ne shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet, andaj gjykata ne nenit 364 par. 1 nenpar 1.3 te KPPRK-se vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

7. Shpenzimet procedurale

Konform nenit 454 par.1 të KPP-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e kësaj gjykate.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,
PKR.nr. 100/20, më datë 24.06.2022.**

**Zyrtarja ligjore,
Teuta Bega**

**Kryetari i Trupit Gjykses,
Kadrije Goga Lubishtani**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.